



VENDIM
Nr. 378, datë 5.6.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT
TEKNIK PËR PAJISJET RADIO,
NJOHJEN E NDËRSJELLË TË
VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT TË
TYRE DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË
STANDARDEVE TË HARMONIZUARA ¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 2, e 42, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 79, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 546, datë 13.6.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

¹ Ky vendim është përfshuar pjesërisht me direktivën 2014/53/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të BE-së të datës 16 Prill 2014, mbi harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me vendosjen në treg të pajisjeve radio dhe shfuqizimin e direktivës 1999/5/EC.

RREGULLI TEKNIK
PËR PAJISJET RADIO, NJOHJEN E
NDËRSJELLË TË VLERËSIMIT TË
KONFORMITETIT TË TYRE DHE
PËRCAKTIMI I LISTËS SË STANDARDEVE
TË HARMONIZUARA

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky rregull teknik zbatohet për pajisjet radio.

2. Ky rregull teknik përcakton kërkesat thelbësore në veprimtarinë e vendosjes në treg, lëvizjes së lirë dhe vënies në shërbim të pajisjeve radio në Republikën e Shqipërisë. Ky rregull teknik zbatohet për të gjitha pajisjet e importuara, si dhe për ato që mund të prodhohen në Shqipëri.

3. Ky rregull teknik nuk do të zbatohet:

a) për pajisjet radio, listuar në aneksin 1;

b) për pajisjet radio, që përdoren ekskluzivisht për aktivitete që lidhen me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë kombëtare dhe aktivitetet e shtetit në fushën e zbatimit të ligjit kundër krimit në Republikën e Shqipërisë.

4. Pajisjet radio, të cilat mbulohen nga ky rregull teknik, nuk do të jenë subjekt i rregullave të pajisjeve elektrike me tension të ulët, përveç përmbyshjes së kërkesës së shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij rregulli.

5. Pajisjet radio, që nuk janë në përputhje me këtë rregull teknik, mund të paraqiten në panairë, ekspozita apo në demonstrime të veçanta vetëm nëse një shënim qartësisht i dukshëm tregon që një pajisje e tillë nuk është në përputhje me këtë rregull teknik dhe nuk mund të vendoset në treg apo në shërbim, deri sa të sillen në konformitet me këtë rregull teknik. Gjatë demonstrimeve merren masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e personave.

Neni 2

Përkufizime

Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, për qëllime të këtij rregulli teknik, termat e më poshtëm kanë këto kuptime:



a) “Pajisje radio”, një produkt elektronik ose elektrik, i cili emeton dhe/ose merr valë radio për qëllime radiokomunikimi dhe/ose radiopërcaktimi, ose një produkt elektronik ose elektrik, i cili duhet të jetë i pajisur me një aksesor të tillë si një antenë, me qëllim emetimin dhe/ose marrjen e valëve radio, për qëllime radiokomunikimi dhe/ose radiopërcaktimi;

b) “Radiokomunikim”, komunikimi me anë të valëve radio;

c) “Radiopërcaktim”, përcaktimi i pozicionit (vendndodhjes), shpejtësisë dhe/ose karakteristikeve të tjera të një objekti, ose marrja e informacionit lidhur me këto parametra, nëpërmjet përhapjes së valëve radio;

ç) “Valë radio”, valët elektromagnetike të frekuencave deri në 3000 GHz, të përhapura në hapësirë;

d) “Ndërfaqe radio”, specififikimet teknike mbi përdorimin e rregulluar të spektrit të frekuencave;

dh) “Klasa e pajisjeve radio”, klasa që identifikon kategori të caktuara të pajisjeve radio, të cilat, sipas këtij rregulli teknik, konsiderohen të ngjashme, si dhe ndërfaqet, për të cilat pajisja radio është projektuar;

e) “Interferencë e dëmshme” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ë) “Shqetësim elektromagnetik”, çdo fenomen elektromagnetik, që mund të dëmtojë performancën e pajisjeve. Një shqetësim elektromagnetik mund të jetë zhurma elektromagnetike, një sinjal i padëshiruar ose një ndryshim në vetë mjedisin e përhapjes;

f) “Operator ekonomik”, prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi ose shpërndarësi;

g) “Bërja e disponueshme në treg”, çdo furnizim i pajisjeve radio për shpërndarje, konsum ose përdorim në treg, gjatë një aktiviteti tregtar, me ose pa pagesë;

gj) “Vendosja në treg”, disponueshmëria për herë të parë e pajisjes radio në treg;

h) “Vendosja në shërbim”, përdorimi për herë të parë i pajisjes radio në vend nga përdoruesi fundor;

i) “Prodhuesi”, çdo person fizik ose juridik, që prodhon pajisje radio ose ka projektuar apo

prodhuar pajisje të tilla dhe i tregton këto pajisje nën emrin e tij ose markën tregtare;

j) “Përfaqësuesi i autorizuar”, çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, që ka marrë një akt përfaqësimi nga një prodhues, për të vepruar në emër të tij në lidhje me detyra specifike;

k) “Specifikime teknike”, një dokument, i cili përshkruan kërkesat teknike që duhet të përmbushen nga pajisja radio;

l) “Pezullim”, çdo masë që synon tërheqjen e pajisjeve radio, të cilat tashmë janë vënë në dispozicion të përdoruesit fundor, për një periudhë të caktuar kohore, deri në rikthimin e tyre në konformitet me kërkesat e parashtruara në këtë rregull teknik;

ll) “Tërheqje”, çdo masë që ka për qëllim parandalimin e bërjes së disponueshme në treg të pajisjes radio;

m) “Legjislacion i harmonizuar”, çdo legjislacion që harmonizon kushtet për tregtimin e produkteve.

Neni 3

Kërkesat thelbësore

1. Pajisjet radio, brenda fushës së zbatimit të këtij rregulli teknik, ndërtohen në mënyrë që të sigurojnë:

a) mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e personave, të kafshëve shtëpiake si dhe mbrojtjen e pronës, duke përfshirë plotësimin e objektivave për kërkesat e sigurisë sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë e pajisjeve elektrike, ku nuk aplikohet një vlerë limit e tensionit;

b) një nivel të përshtatshëm të përputhshmërisë elektromagnetike, sipas legjislacionit në fuqi për përputhshmërinë elektromagnetike.

2. Pajisjet radio ndërtohen në mënyrë të tillë, që të përdorin në mënyrë efektive dhe eficiente spektrin e frekuencave, me qëllim shmangien e interferencave të dëmshme.

3. Pajisjet radio, brenda një kategorie ose klase të caktuar, duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të përmbushin kërkesat thelbësore të mëposhtme:

a) të bashkëveprojnë me aksesore, në veçanti me ushqyes/ngarkues të përbashkët;



b) të bashkëveprojnë nëpërmjet rrjeteve me pajisje të tjera radio;

c) të mund të ndërliken me ndërfaqet e tipit të përshtatshëm në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian;

ç) të mos shkaktojnë dëmtime të rrjetit ose të funksionimit të tij, si dhe të mos keqpërdorin burimet e rrjetit, që mund të shkaktojnë degradime të papranueshme të shërbimit;

d) të përfshijnë masa mbrojtëse për të siguruar mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të përdoruesit dhe pajtimtarit;

dh) të mbështesin cilësi të caktuara, duke siguruar mbrojtjen nga mashtrimet;

e) të mbështesin cilësi të caktuara, duke siguruar akses në shërbimet e emergjencës;

ë) të mbështesin cilësi të caktuara në mënyrë që të thjeshtohet përdorimi i tyre nga përdoruesit me aftësi të kufizuara;

f) të mbështesin cilësi të caktuara, për të siguruar që programi/*software* mund të instalohet vetëm në ato pajisje radio ku demonstron përpunueshmëria e kombinimit të pajisjes radio me programet përkatëse.

4. Në përputhje me praktikën e miratuar nga vendet e Bashkimit Evropian, Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare (në vijim AKEP), publikon periodikisht se cilat kategori ose klasa të pajisjeve radio lidhen me secilën prej kërkesave të pikës 3.

Neni 4

Sigurimi i informacionit mbi konformitetin e kombinimeve të pajisjeve radio dhe programeve

1. Prodhuesit e pajisjeve radio dhe të programeve, që mundësojnë përdorimin e pajisjeve radio sipas qëllimit të tyre, duhet të informojnë autoritetet mbikëqyrëse mbi përpunueshmërinë e kombinimeve të synuara të pajisjeve radio me programet, me kërkesat e nenit 3. Ky informacion sigurohet përmes procedurës së vlerësimit të konformitetit të kryer sipas këtij rregulli, dhe do të jepet në formën e një deklarate konformiteti. Në varësi të kombinimeve specifike të pajisjeve radio me programet, informacioni duhet të identifikojë me saktësi pajisjen radio dhe programet që janë vlerësuar, si dhe të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme.

2. Në përputhje me praktikën e miratuar në vendet e Bashkimit Evropian, AKEP-i publikon periodikisht, se cilat kategori ose klasa të pajisjeve radio lidhen me kërkesat e pikës 1.

3. Rregullat operationale, për të bërë të disponueshëm informacionin mbi konformitetin, për kategoritë dhe klasat e përcaktuara sipas këtij neni, do të përcaktohen me rregullore të AKEP-it.

Neni 5

Regjistrimi i tipave të pajisjeve radio sipas kategorive

1. Duke filluar nga data 1.1.2020, prodhuesit duhet të regjistrojnë tipat e pajisjeve radio, brenda kategorive të pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3, në një regjistër të siguruar nga AKEP-i para se ato kategori të vendosen në treg.

2. Gjatë këtij regjistrimi, prodhuesi duhet të sigurojë disa ose kur lind nevoja, të gjitha të dhënat e dokumentacionit teknik, të përcaktuara në shkronjat “a”, “d” dhe “i”, të aneksit V. Prodhuesit, për çdo pajisje radio të vendosur në treg, duhet të vendosë numrin e regjistrimit, që fiksohet mbi pajisjen radio të vendosur në treg.

3. Specifikimi i kategorive të pajisjeve radio që bien në klauzolat e pikës 1, si dhe elementet e dokumentacionit teknik që duhet të sigurohen në këtë rast, duke marrë në konsideratë informacionin e konformitetit të pajisjes radio, dhe pas vlerësimit të rrezikut të mos zbatimit të kërkesave thelbësore, bëhet me rregullore të miratuar nga AKEP-i, në përputhje me praktikën e BE-së.

4. Rregullat operationale për caktimin e numrit të regjistrimit të pajisjes radio për kategoritë e përcaktuara në pikën 2 do të përcaktohen me rregullore AKEP.

Neni 6

Vendosja në treg

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (në vijim, ISHMT) në bashkëpunim me AKEP-in marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pajisjet radio të mbuluara nga ky rregull, mund të vendosen në treg dhe në



shërbim vetëm nëse janë në përputhje me këtë rregull teknik.

Neni 7

Vendosja në shërbim i pajisjeve radio

1. Pajisjet radio mund të vendosen në shërbim dhe në përdorim vetëm nëse janë në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik, dhe nëse janë instaluar sipas specifikimeve përkatëse si dhe mirëmbahen dhe përdoren për qëllimin e synuar.

2. AKEP-i mund të përcaktojë kërkesa shtesë për vendosjen në shërbim dhe/ose përdorim të pajisjeve radio me qëllim:

- a) përdorimin efektiv dhe eficient të spektrit të frekuencave;
- b) shmangien e interferencave të dëmshme;
- c) shmangien e shqetësimeve elektromagnetike;

ç) sigurimin e shëndetit publik, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe kërkesat e nenit 62, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për administrimin e spektrit të frekuencave.

Neni 8

Njoftimi i specifikimeve të ndërfaqes radio dhe përcaktimet e klasave të pajisjeve radio

1. AKEP-i publikon në faqen e tij zyrtare ndërfaqet radio, që synon të rregullojë më përjashtim të ndërfaqeve radio:

a) të cilat janë në përputhje të plotë ose të pjesshme me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe kërkesat e ligjit mbi përdorimin e harmonizuar të spektrit të frekuencave;

b) të cilat, në përputhje me rregullat zbatuese të përmendur në pikën 2, korrespondojnë me pajisjet radio, të cilat mund të vihen në shërbim dhe përdorim në vendet e Bashkimit Evropian pa kufizime.

2. Me qëllim vlerësimit e vendosjes në shërbim të pajisjes radio, operatori ekonomik duhet të verifikojë në Sistemin Informativ të Frekuencave (EFIS) të Zyrës së Radiokomunikimit Evropian CEPT/ERO, në të cilin specifikohen ndërfaqet radio të disa vendeve evropiane.

Neni 9

Lëvizja e lirë e pajisjeve radio

1. Pajisjet radio, të cilat janë në përputhje me këtë rregull teknik, nuk do të pengohen që të jenë të disponueshëm në treg.

2. Në panaire, ekspozita ose në evente të ngjashme, mund të lejohet vendosja në përdorim e pajisjeve radio që nuk janë në përputhje me këtë rregull teknik, në qoftë se vendoset një shenjë qartësisht e dallueshme, që tregon se pajisje të tilla radio nuk mund të jenë të disponueshëm në treg ose të vihen në shërbim deri në momentin e njohjes së konformitetit të tyre. Demonstrimi i pajisjeve radio mund të realizohet vetëm në rastin kur vërtetohet, se janë marrë masat e duhura, të përcaktuara nga AKEP, për të shmangur interferencat e dëmshme, interferencat elektromagnetike, rrezikun ndaj shëndetit, sigurinë e individëve si dhe mbrojtjen e aseteve.

Neni 10

Detyrimet e prodhuesit

1. Prodhuesi, në momentin që do të vendosë pajisjen radio në treg, duhet të garantojë që pajisja radio të jetë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat thelbësore, përcaktuar në nenin 3.

2. Prodhuesi duhet të garantojë që pajisja radio të jetë projektuar në mënyrë të tillë, që të mund të operojë pa cenuar kërkesat për përdorimin e spektrit të frekuencave.

3. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik dhe kryen procedurat e vlerësimit të konformitetit, të zbatueshme ndaj këtij produkti. Kur nga këto procedura tregohet/demonstrohet përputhshmëria e produktit me kërkesat e zbatueshme, prodhuesi harton deklaratën EC të konformitetit dhe vendos/fikson markimin e konformitetit, bazuar në përcaktimet e pikës 2, neni 10, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

4. Prodhuesi ka detyrim të mbajë dokumentacionin teknik dhe deklaratën e konformitetit për 10 vite pas vendosjes në treg të pajisjes radio.



5. Prodhuksi siguron se zbatohen procedurat që prodhimi në seri të mbetet në konformitet dhe në përputhje me këtë rregull teknik. Ndryshimet në projektimin ose karakteristikat e pajisjes radio dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara ose në specifikimet teknike, sipas të cilave është deklaruar përputhshmëria e pajisjes radio, duhet të merren parasysh.

6. Në rastin kur prodhuesi dyshon se pajisja radio që ai ka vendosur në treg mund të paraqesë rrezik, kryen teste të mostrave të produkteve të tregtuara, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër ankesash për pajisjet radio jo në konformitet, ato të kthyer nga përdoruesi i fundit dhe ato të tërhequra nga tregu, si dhe mban të informuar shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

7. Prodhuksi duhet të garantojë që pajisjet e tyre radio, të cilat janë vendosur në treg, të kenë modelin, numrin e serisë ose një element tjetër, që lejon identifikimin e tyre, ose në rastin kur madhësia, ose natyra e pajisjes radio nuk e lejon atë, atëherë informacioni i kërkuar të sigurohet në paketim, ose në një dokument që shoqëron pajisjen radio.

8. Prodhuksi duhet të përcaktojë në pajisjen radio, emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar, si dhe adresën postare ku mund të kontaktohet. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në pajisjen radio, për shkak se madhësia, ose natyra e pajisjes radio nuk e lejon atë, këto të dhëna duhet të përfshihen në paketim, ose në një dokument që shoqëron pajisjen radio. Adresa duhet të identifikojë një pikë kontakti në të cilën prodhuesi mund të kontaktohet. Të dhënat e kontaktit duhet të jenë në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesi fundor si dhe nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

9. Prodhuksi duhet të sigurojë që pajisja radio të jetë e shoqëruar me udhëzime për përdoruesin, si dhe informacion mbi sigurinë, të shkruar në gjuhën shqipe, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Udhëzimet duhet të përfshijnë informacionin e kërkuar për përdorimin e pajisjes radio, në përputhje me qëllimin e përdorimit të tij. Ky informacion kur është e lejuar, duhet të përfshijë një përshkrim të aksesoreve dhe komponenteve, duke përfshirë programin (*software-in*), që lejon funksionimin e pajisjes radio

sipas qëllimit të tij. Udhëzime të tilla dhe informacioni mbi sigurinë, si dhe çdo etiketim, duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshëm. Gjithashtu, në rastin kur, pajisja radio emeton qëllimisht valë radio, duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

a) Brezi/brezat i/e frekuencave në të cilën operon pajisja radio;

b) Fuqia maksimale e transmetuar në brezin/brezat e frekuencave, në të cilën operon pajisja radio.

10. Prodhuksi duhet të garantojë që çdo pjesë e pajisjes radio të jetë e shoqëruar nga një kopje e deklaratës së konformitetit ose nga një deklaratë konformiteti e thjeshtuar. Kur sigurohet deklarata e konformitetit e thjeshtuar, ajo duhet të përmbajë adresën e saktë të *website* ku mund të gjendet teksti i plotë i deklaratës së konformitetit.

11. Në rastin e kufizimeve në vendosjen në shërbim ose në kërkesat për autorizimin e përdorimit, informacioni i disponueshëm në paketim duhet të identifikojë shtetin anëtar ose zonën gjeografike ku ekzistojnë këto kufizime. Ky informacion duhet të plotësohet në udhëzimet që shoqërojnë pajisjen radio.

12. Prodhuksi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se pajisja radio, të cilën ai e ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me këtë rregull teknik dhe me legjislacionin e në fuqi për produktet jo ushqimore, duhet të marrë menjëherë masat e nevojshme korrigjuese, që ta sjellë pajisjen radio në konformitet, për kthimin nga tregu ose nëse do të jetë e përshtatshme, për të pezulluar përdorimin e saj për një periudhë të caktuar. Për më tepër, kur pajisja radio paraqet rrezik, prodhuesi duhet të njoftojë menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke i dhënë hollësitë, në veçanti për mospërputhshmërinë, të çdo mase korrigjuese të marrë dhe për rezultatet e tyre.

13. Me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, prodhuesi i siguron kësaj të fundit të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në formë shkresore ose formë elektronike, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për këtë strukturë, për të vërtetuar konformitetin e pajisjes radio me këtë rregull teknik. Prodhuksi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisjet radio të vendosura në treg prej tij.



Neni 11

Përfaqësuesi i autorizuar

1. Prodhuesi me një akt përfaqësimi mund të caktojë një përfaqësues (person juridik/fizik) të autorizuar. Detyrimet e përcaktuara në pikën 1 dhe detyrimet për dokumentacionin teknik referuar pikës 3, të nenit 9, nuk do të jenë pjesë e aktit të përfaqësimit, të lëshuar prej tij.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit të lëshuar nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit duhet të lejojë përfaqësuesin e autorizuar të kryejë, të paktën, detyrimet si më poshtë:

a) të mbajë deklaraten EC të konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, për 10 vjet pasi pajisja radio të jetë vendosur në treg;

b) t'i sigurojë strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas një kërkesë nga ana e saj, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar konformitetin e pajisjes radio;

c) të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas një kërkesë të bërë nga ana e saj, për marrjen e masave për eliminimin e rreziqeve që shkaktohen nga pajisja radio, për të cilën është lëshuar akti i përfaqësimit.

Neni 12

Detyrimet e importuesit

1. Importuesit duhet të vendosin në treg, vetëm pajisje radio në përputhje me këtë rregull teknik.

2. Përpara vendosjes në treg të pajisjes radio, importuesi siguron se:

a) prodhuesi i ka kryer procedurat e duhura të vlerësimit të konformitetit sipas këtij rregulli, si dhe pajisja radio të mund të operojë pa shkelur kërkesat e zbatueshme, për përdorimin e spektrit të frekuencave.

b) Është hartuar dokumentacioni teknik dhe se pajisja radio mban markimin CE dhe të jetë e shoqëruar nga informacioni dhe dokumentacioni referuar pikave 8, 9, 10, të nenit 10, si dhe që prodhuesi të ketë plotësuar kërkesat e pikave 6 dhe 7, të nenit 10.

3. Kur importuesi vlerëson ose ka arsye të mendojë se pajisja radio nuk është në konformitet me kërkesat thelbësore përcaktuara në nenin 3, ai nuk duhet të vendosë në treg këtë pajisje radio, deri në momentin që të jetë kryer njohja e konformitetit. Kur pajisja radio përbën rrezik, importuesi duhet të njoftojë prodhuesin dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Importuesi vendos në pajisjen radio emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare në të cilën ai mund të kontaktohet. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në produkt, importuesi i vendos ato në paketim ose në dokumentin shoqëruar të pajisjes radio. Detajet e kontaktit duhet të jenë në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesi fundor dhe nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

5. Importuesi siguron që pajisja radio të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin ose, sipas rastit, udhëzimet për mirëmbajtjen, si dhe nga informacioni për sigurinë në gjuhën shqipe, të cilat duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme.

6. Importuesi siguron se gjatë kohës që pajisja radio është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e produktit me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në nenin 3 të këtij rregulli teknik.

7. Në rastin kur importuesi dyshon se pajisja radio që ai ka vendosur në treg mund të paraqesë rrezik, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, kryen teste të mostrave të pajisjes radio të vënë në treg, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër ankesash për pajisjet radio jo në konformitet dhe atyre të pezulluara nga tregu, si dhe mban të informuar shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

8. Importuesi, i cili konsideron, ose ka arsye për të besuar se pajisja radio që ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me këtë rregull teknik, duhet menjëherë të marrë masat e nevojshme korrigjuese, që pajisja radio të jetë në konformitet, për ta tërhequr nga tregu ose nëse do të jetë e përshtatshme, për ta pezulluar përdorimin e saj për një periudhë të caktuar. Për më tepër, kur pajisja radio shfaq rrezik, importuesi:

a) informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në



veçanti mbi mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë;

b) mban për një periudhë 10-vjeçare, pasi pajisja radio të jetë vendosur në treg, një kopje të deklaratës EC të konformitetit për t'ia vënë në dispozicion strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, dhe siguron që dokumentacioni teknik t'u vihet këtyre strukturave në dispozicion sipas kërkesës.

9. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisja radio e vendosur në treg. Me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duhet t'i sigurojë asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga kjo strukturë, në formë shkresore ose elektronike për të demonstruar konformitetin e pajisjes radio.

Neni 13

Detyrimet e shpërndarësve

1. Kur shpërndarësit bëjnë të disponueshëm pajisjen radio në treg, duhet të veprojnë me kujdesin e duhur për kërkesat e zbatueshme ndaj pajisjes.

2. Përpara bërjes së disponueshme të pajisjes radio në treg, shpërndarësi verifikon që:

a) pajisja radio mban markimin CE të kërkuar;

b) produkti është i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar përkatës sipas këtij rregulli teknik, si dhe me udhëzimet e informacionin për sigurinë në gjuhën shqipe, lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori ose përdoruesi i fundit;

c) prodhuesi dhe importuesi kanë plotësuar kërkesat, në përputhje me pikat 2 dhe 6-10, të nenit 9, dhe të pikës 3, të nenit 11, të këtij rregulli teknik.

3. Kur shpërndarësi vlerëson ose ka arsye për të besuar se pajisja radio nuk është në konformitet me kërkesat thelbësore të nenit 3, ai nuk duhet ta bëjë të disponueshëm në treg pajisjen radio, deri sa pajisja radio të plotësojë kërkesat e konformitetit. Kur pajisja radio shfaq rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin për rrezikun, si dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Shpërndarësi siguron se gjatë kohës që pajisja radio është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit apo të transportimit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore përcaktuar në këtë rregull teknik.

5. Shpërndarësi, i cili vlerëson ose ka arsye për të besuar se pajisja radio, të cilën ai e ka bërë të disponueshëm në treg, nuk plotëson kushtet e konformitetit, është i detyruar të njoftojë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke dhënë informacion të detajuar për mosrespektimin e kërkesave si dhe të masave korrigjuese të marra.

6. Me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, shpërndarësi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, në një gjuhë të kuptueshme nga ana saj në formë shkresore apo elektronike, për të vërtetuar konformitetin e pajisjes radio. Shpërndarësi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, sipas kërkesës së tij, për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisja radio e bërë e disponueshme në treg prej tij.

Neni 14

Rastet në të cilat detyrimet e prodhuesit zbatohen tek importuesi dhe shpërndarësi

Një importues ose shpërndarës konsiderohet prodhues, për qëllime të këtij rregulli teknik, dhe do të jetë subjekt i detyrimeve të prodhuesit, sipas përcaktimeve të nenit 10, kur ai vendos një pajisje radio në treg nën emrin e tij ose markën e tij tregtare ose modifikon pajisjen radio, të vendosur në treg, në mënyrë të tillë, që pajisja radio të mos jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull teknik.

Neni 15

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, mbi bazën e kërkesës të strukturës së mbikëqyrjes së tregut, do të identifikojnë:

a) çdo operator ekonomik që i kane furnizuar ata me pajisje radio;

b) çdo operator ekonomik që ata kane furnizuar me pajisje radio.



2. Operatorët ekonomik duhet të ruajnë informacionin referuar shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, për 10 vjet pasi të kenë/jenë furnizuar subjektet/ nga subjektet me pajisje radio.

Neni 16

Prezumimi i konformitetit

Pajisja radio, e cila është në konformitet me standardet e harmonizuara të publikuara në Fletoren Zyrtare, ose pjesë të saj, prezumohet që është në konformitet me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në nenin 3, të këtij rregulli teknik.

Neni 17

Procedura e vlerësimit të konformitetit

1. Prodhuesi duhet të kryejë procedurën e vlerësimit të konformitetit të pajisjes radio, me qëllim plotësimin e kërkesave thelbësore. Njohja e konformitetit do të marrë në konsideratë të gjitha kushtet operationale të parashikuara, si dhe kushtet e parashikuara në raste të veçanta sipas përcaktimeve të nenit 3. Kur pajisja radio është e aftë të marrë konfigurime të ndryshme, njohja e konformitetit do të vlerësojë pajisjen radio nëse plotëson kërkesat thelbësore në të gjitha konfigurimet e mundshme.

2. Prodhuesi duhet të vërtetojë përputhshmërinë e pajisjes radio me kërkesat thelbësore të pikës 1, të nenit 3, duke përdorur njërin prej procedurave të vlerësimit të konformitetit:

a) Procedura e Kontrollit të Prodhimit të Brendshëm, përcaktuar në aneksin II;

b) Miratimi i Tipit-BE, i cili ndiqet nga konformiteti i tipit, bazuar në kontrollin e prodhimit të brendshëm përcaktuar në aneksin III;

c) Konformiteti, bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë përcaktuar në Aneksin IV.

3. Në rastin kur, në vlerësimin e konformitetit të pajisjes radio me kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të nenin 3, prodhuesi ka aplikuar standarde të harmonizuara, të botuara në Fletoren Zyrtare, sipas listës në aneksin VIII, ai do të përdorë cilindo nga procedurat e mëposhtme:

a) Procedura e Kontrollit të Prodhimit të Brendshëm, përcaktuar në aneksin II;

b) Miratimi i Tipit- BE, i cili ndiqet nga konformiteti i tipit bazuar në kontrollin e prodhimit të brendshëm, përcaktuar në aneksin III;

c) Konformiteti, bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë përcaktuar në aneksin IV.

4. Në rastin kur, në vlerësimin e konformitetit të pajisjes radio me kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 3, prodhuesi nuk ka aplikuar ose ka aplikuar pjesërisht standarde të harmonizuara, referencat e të cilave janë publikuar në Fletore Zyrtare ose kur standarde të tilla të harmonizuara nuk ekzistojnë, pajisja radio duhet të plotësojë kërkesat e domosdoshme në njërin prej procedurave të mëposhtme:

a) Miratimi i tipit-BE, që ndiqet nga konformiteti i tipit bazuar në kontrollin e prodhimit të brendshëm, në përputhje me aneksin III;

b) Konformiteti bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë në përputhje me aneksin IV.

Neni 18

Deklarata EC e Konformitetit

1. Deklarata EC e Konformitetit duhet të vërtetojë plotësimin e kërkesave thelbësore, sipas nenit 3, të këtij rregulli teknik.

2. Deklarata EC e Konformitetit hartohet/përkthehet në gjuhën shqipe dhe përmban elementet e mëposhtme:

a) Numrin e identifikimit unik të produktit;

b) Emrin dhe adresën e prodhuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar;

c) Objektin e deklaratimit (identifikimin e pajisjes radio, që mundëson gjurmueshmërinë, kur shihet e përshtatshme mund të përfshihet edhe një fotografi me qartësi të mjaftueshme për identifikimin e pajisjes), në përputhje me këtë rregull teknik;

ç) Referencën ndaj standardeve të harmonizuara përkatëse që janë zbatuar ose referencën ndaj specifikimeve teknike, në lidhje me të cilat është deklaruar përputhshmëria;

d) Kur është e aplikueshme, organizmin evropian të notifikuar ose degën e tij të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar si organ i miratuar (emri, numri i identifikimit) duke treguar procedurën e vlerësimit të konformitetit dhe lëshimin e certifikatës;

dh) Kur është e aplikueshme, përshkrimin e aksesoreve ose komponentëve, përfshirë këtu edhe *softwar*-ët, të cilët bëjnë të mundur operimin e duhur të pajisjes radio, pjesë përbërëse këto që duhet të jenë të mbuluara nga deklarata EC e konformitetit;

e) Datën, vendin dhe nënshkrimin.

Modeli i kësaj deklarate përcaktohet në aneksin VI të këtij rregulli teknik. Deklarata EC e Konformitetit e thjeshtuar, sipas pikës 9, të nenit 10, do të përmbajë të dhënat e përcaktuara në aneksin VII, do të përditësohet vazhdimisht dhe duhet të jetë në gjuhën shqipe. Teksti i plotë i Deklaratës EC të Konformitetit duhet të jetë i disponueshëm në adresën e internetit të përcaktuar në dokumentin e Deklaratës EC të Konformitetit të Thjeshtuar, në gjuhën shqipe ose atë angleze.

3. Në rastin kur pajisja radio i nënshtrohen më shumë se një akti ligjor të vendeve të Bashkimit Evropian, që kërkon një deklaratë EC të konformitetit, do të hartohet një Deklaratë EC Konformiteti e vetme në lidhje me të gjitha aktet e vendeve të Bashkimit, e cila duhet të përmbajë të gjithë aktet ligjore në fjalë të cilave i nënshtrohet, përfshirë edhe referencat e tyre të botimit.


4. Me hartimin e Deklaratës EC të Konformitetit, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e pajisjeve radio me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull teknik.

Neni 19

Parimet e përgjithshme për markimin CE

1. Markimi CE do të jetë objekt i parimeve të përgjithshme, të përcaktuara në nenit 9, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

2. Bazuar në natyrën e pajisjes radio, lartësia e logos së markimit CE, të paraqitur në foton e mëposhtme, vendosur në pajisjen radio duhet të jetë më pak se 5 mm, duke siguruar që ajo të jetë e dukshme dhe e lexueshme.



Neni 20

Detyrat dhe kushtet për caktimin e markimit CE

1. Markimi CE i konformitetit në pajisjen radio, vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në pajisje ose në pllakën e tij të të dhënave. Kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së pajisjes radio, markimi vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese. Gjithashtu, në paketim, shënimi CE duhet të vendoset në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme, si më poshtë vijon:

a) Markimi CE i konformitetit fiksohet në pajisjen radio përpara vendosjes së saj treg.

b) Markimi CE i konformitetit shoqërohet nga numri i identifikimit të organizmit evropian të notifikuar, i cili i është nënshtrohet procedurës së vlerësimit të konformitetit bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë, në përputhje me aneksin IV. Numri i identifikimit të organizmit evropian të notifikuar duhet të këtë të njëjtën lartësi me markimin CE dhe vendoset/fiksohet nga vetë ai ose, sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Përdorimi i gabuar i markimit CE përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas parashikimeve në ligjin nr.10489 datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

Neni 21

Dokumentacioni teknik

1. Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë të gjitha të dhënat përkatëse ose masat e përdorura nga prodhuesi, për të siguruar që pajisja radio të jetë në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në nenin 3, të këtij rregulli teknik. Ai duhet të përmbajë të paktën, të dhënat e përcaktuara në aneksin V.

2. Dokumentacioni teknik duhet të hartohet përpara se pajisja radio të vendoset në treg dhe do të jetë vazhdimisht i përditësuar.

3. Dokumentacioni teknik dhe korrespondenca lidhur me çdo procedurë të miratimit të tipit- BE, hartuar nga organi i miratuar nga ministri përgjegjës i komunikimeve elektronike, do të jetë në gjuhën shqipe.



4. Në rastin kur dokumentacioni teknik nuk përputhet me pikat e lartpërmendura të këtij neni si dhe dështon në prezantimin e të dhënave të mjaftueshme ose masave për të siguruar konformitetin e pajisjes radio, në përputhje me kërkesat thelbësore përcaktuar në nenin 3, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut mund t'i kërkojë prodhuesit ose importuesit kryerjen e testeve teknike, nga një organizëm i pranueshëm nga ky autoritet, me shpenzime të mbuluara nga vet prodhuesi ose importuesi, brenda një periudhe të caktuar, në mënyrë që të verifikojnë përputhshmërinë e pajisjeve radio me kërkesat thelbësore.

Neni 22
Autoriteti miratues

1. Ministri përgjegjës për komunikimet elektronike është autoriteti miratues për organet e vlerësimit të konformitetit për pajisjet radio.

2. Në përmbushjen e detyrave të miratimit për organet e vlerësimit të konfirmimit për pajisjet radio, autoriteti miratues, siguron përmbushjen e të gjitha kërkesave të nenit 17, të ligjit nr. 10489 datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, të ndryshuar, nga strukturat përgjegjëse të ngarkuara.

Neni 23
Akreditimi i organeve të vlerësimit të konformitetit

Për qëllime të miratimit nga autoriteti miratues, organet e vlerësimit të konformitetit duhet të jenë paraprakisht të akredituara për aktivitetin e vlerësimit të konformitetit, për të cilat kërkojnë miratim.

Neni 24
Kërkesat lidhur me organet e miratuara

1. Për qëllime të miratimit, një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) Të jetë i regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri dhe të ketë përgjegjësi ligjore për aktivitetin e vlerësimit të konformitetit të pajisjeve radio;

b) Të jetë i akredituar. Në rastet kur procedura e vlerësimit të konformitetit kërkon përfshirjen e organeve të vlerësimit të konformitetit si palë e tretë për vendosjen e markimit CE, ato mund të jenë vetëm organizma evropianë të notifikuar ose degë të tyre të regjistruara në Shqipëri dhe të miratuara nga ministri përgjegjës. Në rastin e degëve të organizmave evropianë të notifikuar, që duan të operojnë në Shqipëri, si organe të miratuara për vendosjen e markimit CE, kjo certifikatë duhet të jetë e lëshuar nga një organizëm akreditimi i një shteti anëtar të BE-së dhe anëtar i Organizatës Evropiane të Akreditimit për fushën përkatëse. Në këtë rast “Certifikata e akreditimit” duhet të mbulojë funksionimin/veprimtarinë e këtij organizmi në territorin shqiptar për fushën përkatëse. Në rastin e organeve të vlerësimit të konformitetit, që duan të operojnë si organe të miratuara për qëllime të inspektimit të rregullt periodik të produkteve të vëna në shërbim, certifikata e akreditimit duhet të jetë e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm tjetër akreditimi që është nënshkruar i marrëveshjes shumëpalëshe me Organizatën Evropiane për Akreditimin për fushën përkatëse. Në rastin e fundit, “Certifikata e akreditimit” duhet të mbulojë funksionimin/veprimtarinë e këtij organizmi në territorin shqiptar.

c) Të jetë një organ i palës së tretë, i pavarur nga organizata ose pajisjet radio që vlerëson;

ç) Të jetë në gjendje të kryejë të gjitha detyrat e vlerësimit të konformitetit sipas Aneksit III dhe në lidhje me të cilat ai është miratuar, nëse këto detyra kryhen nga vetë organi i vlerësimit të konformitetit, ose në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që nëse një organizëm që i përket një shoqate biznesi, ose një federate profesionale që përfaqëson ndërmarrjet e përfshira në projektimin, prodhimin, furnizimin, montimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e pajisjeve radio që vlerëson, mund të konsiderohet një organizëm i tillë, me kusht që të demonstron pavarësinë e tij dhe mungesa e ndonjë konflikti interesi.

2. Në çdo kohë dhe për çdo procedurë të vlerësimit të konformitetit, dhe çdo lloj ose kategori pajisjesh radio në lidhje me të cilat është miratuar, organi i miratuar i vlerësimit duhet të plotësojë kërkesat e parashtruara sipas pikave 5-



12, të nenit 19, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.

Neni 25

Prezumimi i konformitetit të organeve të miratuar

Kur një organ i vlerësimit të konformitetit vërteton konformitetin e tij me kriteret e përcaktuara të standardeve përkatëse të harmonizuara ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare, prezumohet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 24, të këtij rregulli teknik, për aq kohë sa standardet e aplikueshme të harmonizuara i mbulojnë këto kërkesa.

Neni 26

Filialet dhe nënkontraktorët e organeve të miratuar

1. Kur një organ i miratuar nënkontraktin detyra specifike lidhur me vlerësimin e konformitetit, ose ka lidhje me një filial, ai duhet të sigurojë që nënkontraktori ose filiali të plotësojë kërkesat e përcaktuara në nenin 24, si dhe duhet të informojë autoritetin miratues dhe DPA-në, sipas rastit.

2. Organet e miratuara kanë përgjegjësi të plotë për detyrat e kryera nga nënkontraktorët ose filialet, kudo që ato janë themeluar.

3. Aktivitetet referuar pikës 1 do të nënkontraktohen ose kryhen nga një filial/degë vetëm me marrëveshjen e klientit.

4. Organi i miratuar duhet të vëre në dispozicion të autoritetit miratues dhe DPA-së, dokumentet përkatëse, në lidhje me vlerësimin e kualifikimeve të nënkontraktuesit ose filialit dhe punën e kryer sipas anekseve III dhe IV, të këtij rregulli teknik.

Neni 27

Aplikimi për miratim

1. Organet e vlerësimit të konformitetit, me qëllim kryerjen e veprimtarisë së tyre, duhet të plotësojnë formularin e aplikimit të miratimit, duke e dërguar atë në autoritetin miratues në formë elektronike ose shkresore.

2. Autoriteti miratues, brenda 5 ditëve, nga paraqitja e aplikimit, i kërkon DPA-së, të sigurojë aksesin, konsultimin ose kopjen e certifikatës së akreditimit dhe të aneksit përkatës teknik, duke vërtetuar:

a) se pala e interesuar është e pajtueshme, duke plotësuar kërkesat e parashtruara në nenin 24;

b) kompetencën e palës së interesuar, për kryerjen e aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit, të modulit ose moduleve të vlerësimit të konformitetit, dhe të pajisjeve ose llojit të pajisjeve përkatëse.

Neni 28

Procedura e miratimit

1. Autoritetit miratues njofton organet e vlerësimit të konformitetit për miratimin ose refuzimin e miratimit me argumentet përkatëse.

2. Miratimi duhet të përfshijë detaje të plota të aktiviteteve e modulit/eve të vlerësimit të konformitetit, pajisjeve radio përkatëse, si dhe të dhënat e parapërcaktuara në kërkesat e pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr. 10489/2011. Fusha e miratimit duhet të jetë e përfshirë në fushën e akreditimit..

Neni 29

Ndryshimet në miratim

1. Kur autoriteti miratues konstaton ose është njoftuar, që një organ i miratuar nuk plotëson më kërkesat përcaktuar në nenin 24, ose që ka dështuar në plotësimin e detyrimeve të tij, autoriteti miratues kufizon, pezullon ose revokon njoftimin sipas rastit, në varësi të seriozitetit të dështimit për të plotësuar kërkesat ose detyrimet e këtij rregulli teknik.

2. Kufizimi ose ndërhyrja nga ana e autoritetit miratues do të bëhet vetëm pas vlerësimit nga ana e DPA-së, se OMK nuk plotëson kërkesat e nenit 24.

3. Në rast të kufizimit, pezullimit ose tërheqjes së miratimit, ose kur organi i miratuar ka ndërprerë veprimtarinë e tij, autoriteti miratues ndërmer hapat e nevojshme për të garantuar që dosjet e atij organi të përpunohen nga një organ tjetër i miratuar.



Neni 30

Detyrimet operacionale të organeve të miratuara

1. Organet e miratuara duhet të kryejnë vlerësimin e konformitetit në përputhje me procedurat e vlerësimit së konformitetit sipas anekseve III dhe IV.

2. Vlerësimi i konformitetit do të kryhet në mënyrë proporcionale, duke shmangur barrën e panevojshme për operatorët ekonomik, gjithashtu të gjithë organizmat duhet të marrin parasysh madhësinë e një sipërmarrësi, sektorin në të cilin vepron, strukturën e tij, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së pajisjes radio në fjalë, dhe masën ose natyrën e serisë të procesit të prodhimit.

3. Organet e miratuara duhet të respektojnë shkallën e ashpërsisë dhe nivelin e mbrojtjes së kërkuar, për pajtueshmërinë e pajisjes radio me këtë rregull teknik.

4. Kur organi i miratuar konstaton se kërkesat thelbësore përcaktuar në aneksin 1, ose standardet e harmonizuara korresponduese, si dhe specifikime të tjera teknike nuk janë plotësuar nga prodhuesi, ai duhet t'i kërkojë prodhuesit të ndërmarrë masa korrigjuese duke mos i miratuar certifikatën.

5. Nëse organi i miratuar, gjatë monitorimit të konformitetit, pas lëshimit të certifikatës, konstaton që pajisja radio nuk përmbush konformitetin, ai i kërkon prodhuesit që të marrë masat e duhura korrigjuese dhe në rastet kur është e nevojshme pezullon ose revokon certifikatën.

6. Nëse masat korrigjuese nuk zbatohen, ose nuk kanë efektet e dëshiruar, organi i miratuar do të kufizojë, pezullojë ose revokojë çdo certifikatë, sipas rastit.

Neni 31

Apelimi kundër vendimeve të organeve të miratuara

1. Organet e miratuara duhet të kenë në dispozicion një procedurë ankimore të detyrueshme për zbatim në raste apelimesh ndaj vendimeve që ato nxjerrin.

2. Organi i miratuar duhet të publikojë procedurat e referuara në pikën 1, të këtij neni.

3. Vendimet ndaj apelimeve të vendimeve të organeve të miratuara mund të kundërshtohen në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 32

Informacioni i detyruar mbi organet e miratuara

1. Organet e miratuara duhet të informojnë autoritetin miratues për:

a) çdo refuzim, kufizim, pezullim ose revokim të certifikatës së miratim-tipit EU ose sistemi cilësorë të miratuar;

b) çdo situatë që afekton qëllimin ose kushtet për njoftimin;

c) çdo kërkesë për informacion, që ata kanë marrë nga autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut në lidhje me procedurat e vlerësimit së konformitetit;

ç) sipas kërkesës, procedurat e kryera të vlerësimit të konformitetit brenda qëllimit të njoftimit dhe çdo procedurë tjetër që përfshin procedurat ndërkuftare dhe nënkontraktimet.

2. Organet e miratuara duhet që:

a) në përputhje me kërkesat e anekseve III dhe IV, të këtij rregulli teknik, t'i sigurojnë organeve të tjera të miratuar, që kryejnë procedura të ngjashme të vlerësimit të konformitetit, dhe që mbulojnë të njëjtat kategori të pajisjeve radio, informacionin përkatës, mbi çështje që kanë të bëjnë me rezultatet negative, dhe sipas kërkesës me rezultatet pozitive të vlerësimit të konformitetit;

b) të plotësojnë informacionin e detyruar sipas anekseve III dhe IV.

Neni 33

Koordinimi i organeve të miratuar/notifikuar

Organet e miratuar/notifikuar marrin pjesë, drejtpërsëdrejti ose me anë të përfaqësuesve të caktuar, në grupet përkatëse të koordinimit dhe bashkëpunimit, të organizuara nga Komisioni Evropian.

Neni 34

Mbikëqyrja dhe kontrolli i tregut për pajisjet radio

Mbikëqyrja e tregut e pajisjeve radio bëhet në zbatim të legjislacionit në fuqi lidhur me produktet joushqimore.



AKEP-i dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, të cilët, në zbatim të këtij vendimi lidhin marrëveshje bashkëpunimi midis tyre, janë strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për pajisjet radio.

Objektivat kryesorë të mbikëqyrjes së tregut të pajisjeve radio synojnë që:

- a) të sigurojë që produktet në treg përputhen me kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik;
- b) të kontrollojë nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë rregull teknik;
- c) të kontrollojë që fiksimi dhe përdorimi i markimit CE është korrekt dhe nëse janë respektuar kërkesat lidhur me markime të tjera shtesë.

Deklaratat e konformitetit duhet të jenë të disponueshme sa herë që ato të kërkohen nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut. Për më tepër, çdo produkt duhet të jetë i shoqëruar deri të përdoruesi me deklaratën e konformitetit.

Në rast se pajisjet e vendosura në treg janë në mospërputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregull teknik, AKEP-i duhet të marrë masa në përputhje me legjislacionin në fuqi.

AKEP-i ka autoritetin të ndalojë, të kufizojë ose të tërheqë nga përdorimi pajisjet radio, që shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë interferenca të dëmshme.

Pronari i pajisjeve radio nuk ka të drejtë të pengojë inspektimin dhe është i detyruar të bashkëpunojë dhe të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm sa herë që kërkohet një gjë e tillë.

Nëse gjatë inspektimit nevojitet një ekspertizë e veçantë, atëherë mund të merren edhe ekspertë të tjerë në fusha të caktuara.

Kur gjatë inspektimit verifikohet që aparatet në përdorim, nuk përputhen me këtë rregull teknik, AKEP-i duhet të marrë masat e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut njofton autoritetin miratues çdo vit mbi aktivitetin e mbikëqyrjes së tregut, duke paraqitur një raport shoqëruar me të dhëna statistikore, si dhe të sigurojnë informacion mbi konformitetin e pajisjeve radio në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik, duke përfshirë dhe kërkesat mbi identifikimin e operatorëve ekonomik.

Neni 35

Procedura për trajtimin e pajisjeve radio, të cilat paraqesin rrezik në nivel kombëtar

1. Në rast se autoriteti/et përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut ka arsye të mjaftueshme të besojë se pajisjet radio të mbuluara nga ky rregull teknik paraqesin rrezik për aspektet e mbrojtjes së interesit publik, ai do të kryejë një vlerësim në lidhje me pajisjet radio të cilat plotësojnë të gjitha kërkesat e nevojshme të përcaktuara në këtë rregull teknik.

2. Operatorët ekonomik përkatës duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me autoritetin përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut.

3. Në rast se, lidhur me vlerësimin e parashikuar në pikën 1, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut konstaton se pajisjet radio nuk përmbushin kërkesat e parashtruara në këtë rregull teknik, ai duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik përkatës të marrë menjëherë të gjitha veprimet e duhura që pajisja radio të përmbushë kërkesat thelbësore, duke i tërhequr nga tregu ose duke i pezulluar për një periudhë të caktuar, në proporcion me natyrën e rrezikut.

4. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut duhet të informojë autoritetin miratues mbi vlerësimin dhe masat që i ka kërkuar operatorit ekonomik të marrë në përputhje me përcaktimet e pikës 3 dhe kërkesave të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

5. Në rast se autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut vlerëson se mungesa e konformitetit e pajisjeve radio nuk kufizohet vetëm në vend, ky i fundit duhet të informojnë strukturat homologe në vendet e tjera për rezultatet e vlerësimit dhe për masat që i kanë kërkuar operatorit ekonomik të marrë.

6. Operatori ekonomik duhet të garantojë se janë marrë të gjitha masat e duhura korrigjuese, në lidhje me të gjitha pajisjet radio që ka vendosur në treg në BE.

7. Në rast se operatori ekonomik përkatës nuk merr masat e duhura korrigjuese brenda periudhës së përcaktuar në pikën 3, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut duhet të marrë masat e nevojshme për të ndaluar ose kufizuar vendosjen në treg të pajisjeve radio, si



dhe t'i tërheqë ato nga tregu ose t'i pezullojë për një periudhë të caktuar.

8. Informacioni që duhet bërë i njohur, sipas pikës 7, duhet të përmbajë të gjitha detajet e disponueshme, në veçanti të dhënat e nevojshme për identifikimin e pajisjeve radio jokonform, origjinën e pajisjeve radio, llojin e jokonformitetit dhe natyrën e rrezikut, llojin dhe kohëzgjatjen e masave kombëtare të ndërmarra, si dhe argumentet e përcjella nga operatorët ekonomikë përkatës.

9. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut duhet të shprehin qartë arsyen e mungesës së konformitetit, të tillë si:

a) dështimi i pajisjeve radio për të plotësuar kërkesat thelbësore që lidhen me aspekte të mbrojtjes së interesit publik, të cilat mbulohen nga ky rregull teknik;

b) mangësi në standardet e harmonizuara, në përputhje me nenin 16, i cili shpreh konformitetin e supozuar.

10. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut, duhet të informojë organet homologe në vendet e Bashkimit Evropian, pa vonesë, për çdo masë të miratuar dhe çdo informacion shtesë në dispozicion të tij, që lidhen me mungesën e konformitetit të pajisjeve radio, si dhe, në rast të mosmarrëveshjeve, me masat kombëtare të miratuara në kundërshtim.

11. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut, në këto rrethana, duhet të garantojë se janë marrë masat kufizuese të përshtatshme, për pajisjet radio në fjalë, të tilla si heqja e tyre nga tregu.

Neni 36

Procedura e mbrojtjes

1. Kur, pas përfundimit të procedurës së përcaktuar në pikat 6 deri 8 të nenit 35, ngrihen kundërshtime ndaj një mase që është marrë, ose kur autoriteti miratues e konsideron atë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, autoriteti miratues do të vlerësojë nëse masa kombëtare është e justifikuar apo jo.

2. Kur masa kombëtare konsiderohet e justifikuar, AKEP-i do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pajisja radio jo në konformitet të tërhiqet ose të pezullohet nga tregu.

3. Nëse masa kombëtare konsiderohet e pajustifikuar, autoriteti mbikëqyrës i tregut revokon atë masë.

Neni 37

Pajisjet radio që paraqesin rrezik, pavarësisht konformitetit të tyre

1. Kur provohet se, pavarësisht përputhshmërisë së pajisjes radio me kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik, kjo pajisje paraqet rrezik për sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit dhe interesave të tjerë publikë, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut, i kërkon operatorit ekonomik të marrë masa në përputhje me përcaktimet e pikës 3, neni 6, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

2. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të merren të gjitha masat korrigjuese, lidhur me pajisjet radio problematike.

3. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut, për sa më sipër, duhet të njoftojë menjëherë organet përgjegjëse në Bashkimin Evropian. Informacioni duhet të përfshijë të gjitha detajet e nevojshme, në veçanti të dhëna për identifikimin e pajisjes radio problematike, origjinën dhe historikun e furnizimit të tij, natyrën e rrezikut si dhe natyrën dhe kohëzgjatjen e masave kombëtare të ndërmarra.

Neni 38

Mospërputhja formale

1. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut, pa paragjykuar përcaktimet e nenit 35, në rastin kur konstatohen shkeljet e mëposhtme, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të marrë masat e nevojshme për të plotësuar mungesën e konformitetit, që vjen si rezultat i:

a) markimit CE në kundërshtim me nenin 9, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar ose me nenin 19, të këtij rregulli teknik;

b) mos caktimit të markimit CE;



c) caktimit të numrit të identifikimit të organizmit notifikues, në të cilin është aplikuar procedura e vlerësimit të konformitetit sipas aneksit IV, në kundërshtim me nenin 19 ose kur ky numër identifikimi nuk është caktuar aspak;

ç) moshartimit të Deklaratës EC të Konformitetit;

d) moshartimit saktësisht i Deklaratës EC të Konformitetit;

dh) padisponueshmërisë së dokumentacionit teknik ose në rastin kur ky dokumentacioni nuk është i plotë;

e) mungesës së informacionit të kërkuar në pikat 6 – 8, të nenit 9, ose në pikën 3, të nenit 11, ose në rastin kur ky informacion është i pavërtetë ose jo i plotë;

ë) mungesës, si pjesë shoqëruese e pajisjes radio, së informacionit mbi qëllimin e përdorimit të pajisjes, deklaratës EC të konformitetit ose të kufizimeve të përdorimit sipas përcaktimeve të pikave 8 – 10, të nenit 9;

f) mos plotësimi të kërkesave për identifikimin e operatorëve ekonomik, sipas përcaktimeve të nenit 14;

g) mos zbatimit të përcaktimeve të nenit 5.

2. Në rastet kur shkeljet e mësipërme nuk parandalohen, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut duhet të marrë masat e duhura për të kufizuar ose ndaluar pajisjet radio përkatëse, që janë bërë të disponueshme në treg, për të siguruar pezullimin e tyre për një kohë të caktuar ose për të bërë tërheqjen nga tregu.

ANEKSI I

PAJISJET QË NUK MBULOHEN NGA KY RREGULL TEKNIK

1. Pajisja radio që përdoret nga radioamatorët sipas përcaktimit të pikës 56, të nenit 1, të Radio Rregulloreve të ITU-së, përveç rastit kur pajisja është e mundshme për t'u tregtuar;

2. Pajisje radio të cilat nuk do të konsiderohen të mundshme për t'u tregtuar si më poshtë:

a) Pjesët përbërëse të komponentëve për montim dhe përdorim nga radioamatorët;

b) Pajisjet radio të modifikuara, dhe për përdorim nga radioamatorët;

c) Pajisje të ndërtaura nga radioamator, për qëllime shkencore dhe eksperimentale;

ç) Pajisjet e marinës;

d) Pajisje të caktuara që përdoren në aviacionin civil në përputhje me nenin 3, të udhëzimit nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar.

3. Pajisje vlerësuese të personalizuar, për përdorim nga profesionist vetëm për qëllime kërkimore dhe zhvillimore.

ANEKSI II

PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT MODULI A KONTROLLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT

1. Procedura e vlerësimit të konformitetit me anë të kontrollit të brendshëm të prodhimit përmes së cilës prodhuesi plotëson të gjitha detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij aneksi, si dhe siguron dhe deklaron nën përgjegjësinë e tij se të gjitha pajisjet radio në fjalë plotësojnë kërkesat thelbësore, përcaktuar në nenin 3 të këtij rregulli teknik.

2. Prodhuesi duhet të hartojë dokumentacionin teknik sipas përcaktimeve të nenit 20.

3. Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë të tillë që, procesi i prodhimit dhe i monitorimit, të sigurojë pajtueshmëri të prodhimit të pajisjeve radio me dokumentacionin teknik, duke marrë në konsideratë përcaktimet e pikës 2, të këtij aneksi si dhe të kërkesave thelbësore të nenit 3.

4. Markimi CE dhe Deklarata e Konformitetit BE:

i) Prodhuesi duhet të fiksojë markimin CE, në përputhje me nenin 18 dhe 19, në çdo tip pajisje radio që plotëson kërkesat thelbësore.

ii) Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim deklaratën e konformitetit BE, për çdo pajisje radio dhe së bashku me dokumentacionin teknik duhet ta ketë të disponueshëm për autoritetet kombëtare për 10 vite pas vendosjes në treg të pajisjes radio. Deklarata e Konformitetit BE duhet të identifikojë pajisjen radio për të cilën është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit BE duhet të bëhet i disponueshëm për Autoritetet e Mbikëqyrjes së Tregut sipas kërkesës.

5. Detyrimet e prodhuesit në pikën 4 mund të plotësohen dhe nga përfaqësuesi i tij i autorizuar,



me kusht që detyrimet të jenë të specifikuar në marrëveshje.

ANEKSI III
PROCEDURA E VLERËSIMIT TË
KONFORMITETIT MODULI B DHE C
MIRATIMI I TIPIT- NË VENDET E BE
DHE KONFORMITETI BAZUAR NË
PROCEDURËN E KONTROLLIT TË
BRENDSHËM TË PRODHIMIT

Referuar këtij aneksi, procedura e vlerësimit të konformitetit do të jetë sipas Modullit B (Miratim Tipi- BE) dhe C (Konformiteti bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit).

Moduli B
Miratim Tipi-BE

1. Miratimi i Tipit- BE është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit, sipas së cilës autoriteti miratues analizon skemën teknike të pajisjes radio duke vlerësuar dhe deklaruar se ndërtimi teknik i pajisjes radio përmbush kërkesat thelbësore të nenit 3.

2. Miratimi i Tipit-BE do të kryhet duke vlerësuar përshtatshmërinë e skemës teknike të pajisjes radio referuar dokumentacionit teknik dhe dëshmimeve përkatëse të përmendura në pikën 3, pa nevojën e vlerësimit të ndonjë ekzemplari (lloji i projektimit).

3. Prodhuesi duhet të depozitojë aplikimin për miratimin e Tipit-BE të një organizmi të njoftuar sipas zgjedhjes së tij.

Aplikimi duhet të përmbajë:

a) Emrin dhe adresën e prodhuesit, dhe nëse aplikimi bëhet nga përfaqësuesi i tij autorizuar gjithashtu dhe emrin dhe adresën e këtij të fundit;

b) Një deklaratë me shkrim se një aplikim i ngjashëm nuk është depozituar më parë tek asnjë organ tjetër të miratuar;

c) Dokumentacionin teknik. Dokumentacioni teknik duhet të specifikojë kërkesat e zbatueshme dhe plotësimin e tyre, sa i përket vlerësimit, projektimit, prodhimit dhe funksionimit të pajisjeve radio. Dokumentacioni teknik duhet të përfshijë të gjitha elementet e përcaktuara në aneksin V;

ç) Vërtetim/Dëshmi mbi përshtatshmërinë e zgjedhjes teknike të projektimit. Ky Vërtetim/Dëshmi duhet të citojë çdo dokument që është përdorur, veçanërisht kur standardet përkatëse të harmonizuara nuk janë zbatuar, ose kur ato janë zbatuar pjesërisht. Vërtetimi/Dëshmia duhet të përfshijë, kur është e nevojshme, rezultatet e testeve, të kryera në përputhje me specifikimet e tjera teknike nga laboratorit përkatës i prodhuesit, ose nga një laborator tjetër testues në emër dhe nën përgjegjësinë e tij.

4. Organi i miratuar do të vlerësojë përputhshmërinë e dokumentacionit teknik, duke u mbështetur në dëshmi, për të vlerësuar përshtatshmërinë e dizajnit teknik të pajisjeve radio.

5. Organi i miratuar do të hartojë një raport vlerësimi, i cili do të përfshijë aktivitetet e ndërmarra në përputhje me pikën 4 si dhe rezultatet e tyre. Pa paragjykuar detyrimet e tij siç parashikohet në pikën 8, organi i miratuar do të publikojë përmbajtjen e raportit, plotësisht ose pjesërisht, vetëm me dakordësinë e prodhuesit.

6. (i) Kur plotësohen të gjitha kërkesat referuar pajisjes radio përkatëse, Organi i miratuar pajis prodhuesin me një Certifikatë Miratim Tipi- BE. Certifikata duhet të përmbajë emrin dhe adresën e prodhuesit, përfundimet e vlerësimit, aspektet e kërkesave kryesore të mbuluara nga vlerësimi, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë e tij, dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e tipit të vlerësuar. Certifikata e Miratimit të Tipit mund të ketë një ose më shumë anekse bashkëlidhur.

(ii) Certifikata e Miratimit të Tipit-BE dhe anekset e tij duhet të përmbajnë të gjithë informacionin përkatës, për të lejuar konformitetin e pajisjes radio të prodhuar, dhe për të lejuar kontrollin në shërbim.

(iii) Kur aplikimi për Miratimin e Tipit-BE nuk kënaq kërkesat e këtij rregulli teknik, organi i miratuar refuzon lëshimin e Certifikatës së Miratimit të Tipit dhe njofton aplikantin duke dhënë arsyetime të detajuara për refuzimin e aplikimit të tij.

7. (i) Organi i miratuar duhet të jetë i informuar për çdo ndryshim që vërteton se tipi i miratuar nuk mund të jetë më në përputhje me kërkesat e zbatueshme të këtij rregulli teknik, dhe duhet të përcaktojë nëse këto ndryshime



kërkojnë hetime të mëtejshme. Si rrjedhojë, organi i miratuar duhet të informojë prodhuesin sipas rastit.

(ii) Prodhuesi duhet të informojë organin e miratuar se disponon dokumentacionin teknik në lidhje me Certifikatën e Miratimit të Tipit-BE, për të gjitha ndryshimet e tipit të miratuar që mund të ndikojnë përputhshmërinë e pajisjes radio me kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik ose kushteve për vlefshmërinë e kësaj Certifikate. Modifikime të tilla kërkojnë aprovim plotësues në formën e një shtese në Certifikatën e Miratimit të Tipit- BE.

8. (i) Çdo organ i miratuar duhet të informojë Autoritetin miratues në lidhje me Certifikatën e Miratimit të Tipit- BE dhe/ose çdo ndryshim/shtesë e cila është miratuar ose shfuqizuar, si dhe duhet që periodikisht ose sipas kërkesës, të bëjë të disponueshme në autoritetin miratues listën e certifikatave dhe/ose çdo shtesë/ndryshim të refuzuar, pezulluar ose kushtëzuar.

(ii) Çdo organ i miratuar duhet të informojë organin tjetër të miratuar lidhur me Certifikatën e Miratimit të Tipit-BE dhe/ose çdo shtesë për të cilën ajo është refuzuar, shfuqizuar, pezulluar ose kushtëzuar, dhe sipas kërkesës lidhur me certifikatat dhe/ose shtesa të cilat janë miratuar.

(iii) Çdo organ i miratuar duhet të informojë vendet e BE për Certifikatën e Miratimit të Tipit-BE që ai ka lëshuar dhe/ose shtesat në ato raste kur standardet e harmonizuara, referencat e të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare nuk janë aplikuar ose nuk janë zbatuar plotësisht. Vendet e Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian dhe organet e tjera të miratuara/notifikuara, mbi bazë të kërkesës, sigurojnë një kopje të Certifikatës së Miratimit të Tipit- BE dhe/ose shtesat e saj. Mbi bazë të kërkesës vendet anëtare të BE-së dhe Komisioni mund të sigurojnë një kopje të dokumentit teknik si dhe rezultatet e ekzaminimit të kryer nga organi i miratuar. Organi i miratuar duhet të ruajë një kopje të Certifikatës së Miratimit të Tipit- BE, anekset e tij dhe ndryshimet, si dhe dokumentet teknik duke përfshirë dhe dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi, për një afat 10-vjeçar, nga data e vlerësimit të pajisjes radio ose deri në përfundimin e vlefshmërisë së certifikatës.

9. Prodhuesi duhet të ruaj një kopje të Certifikatës së Miratimit të Tipit- BE, anekset e tij dhe plotësimet së bashku me dokumentacionin teknik në disponueshmëri të autoriteteve kombëtare, për një periudhë 10-vjeçare, pas vendosjes në treg të pajisjes radio.

10. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të plotësojë aplikimin referuar pikës 3, si dhe detyrimet përcaktuar në pikat 7 dhe 9, me kusht që ato të specifikohen në marrëveshje.

Moduli C

Procedura e miratimit të tipit bazuar në kontrollin e prodhimit të brendshëm

1. Procedura e miratimit të tipit bazuar në kontrollin e prodhimit të brendshëm është pjesë përbërëse e procedurës së Njohjes së Konformitetit, ku prodhuesi përmbush detyrimet e pikës 2 dhe 3 më poshtë, si dhe siguron dhe deklaron se pajisja radio në fjalë është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e miratimit të tipit-BE, si dhe kënaq kërkesat e këtij rregulli teknik.

2. Prodhuesi

Prodhuesi duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë të tillë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë përputhshmërinë e pajisjes radio të prodhuar, me miratimin e tipit përshkruar në Certifikatën e Miratimit të Tipit-BE si dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik.

3. Markimi CE dhe deklarata e konformitetit në vendet e BE

i) Prodhuesi duhet të fiksojë markimin CE në përputhje me nenet 18 dhe 19 për çdo pajisje radio, e cila është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e miratimit të tipit-BE, si dhe të plotësojë kërkesat e këtij rregulli teknik;

ii) Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë konformiteti për çdo pajisje radio dhe duhet ta ruaj atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare, për një periudhë 10 vjeçare pasi pajisja të jetë vendosur në treg.

Një kopje e deklaratës së konformitetit BE duhet t'i vihet në dispozicion autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

4. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit në pikën 3 mund të plotësohen dhe nga përfaqësuesi i tij i autorizuar,



me kusht që detyrimet të jenë të specifikuara në marrëveshje.

ANEKSI IV
VLERËSIMI I KONFORMITETIT
MODULI H
KONFORMITETI BAZUAR NË
SIGURIMIN E PLOTË TË CILËSISË

1. Konformiteti bazuar në sigurinë e plotë të cilësisë është procedura e vlerësimit të konformitetit, përmes së cilës prodhuesi plotëson detyrimet, përcaktuar në pikat 2 dhe 5 dhe siguron dhe deklaron nën përgjegjësinë e tij, se pajisja radio në fjalë plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të ketë një sistem të miratuar të cilësisë për projektimin, prodhimin, inspektimin përfundimtar të pajisjes radio dhe testimin, në përputhje me specifikimet e pikës 3 dhe duhet të jetë objekt i mbikëqyrjes sipas përcaktimit të pikës 4.

3. Sistemi i cilësisë

1. Prodhuesi do të paraqesë një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë në organin e miratuar të zgjedhur prej tij, për pajisjet radio në fjalë.

Aplikimi duhet të përfshijë:

a) Emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse aplikimi bëhet nga përfaqësuesi i tij i autorizuar emrin dhe adresën e tij gjithashtu;

b) Dokumentacionin teknik, për secilën pajisje radio që synohet të prodhohet. Dokumentacioni teknik duhet të përfshijë, aty ku është e mundur, kërkesat e aneksit V;

c) Dokumentacionin referuar sistemit të cilësisë;

ç) Një deklaratë me shkrim ku të citohet se asnjë aplikim i ngjashëm nuk është kryer në një organ tjetër i miratuar.

2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhshmërinë e pajisjes radio me kërkesat e këtij rregulli teknik.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe përcaktimet e miratuara nga prodhuesi duhet të jenë të dokumentuara në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë do të garantojë një interpretim

të qëndrueshëm të programeve të cilësisë, planeve, manualeve dhe të dhënave.

Ai duhet, në veçanti, të përmbajë një përshkrim të përshtatshëm të:

i) objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhimit në lidhje me projektimin dhe cilësinë e produktit;

ii) specifikimeve teknike të projektimit, duke përfshirë standardet, që do të aplikohen si dhe standardët përkatëse të harmonizuara të cilat nuk do të aplikohen plotësisht, për të siguruar mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave thelbësore të këtij rregulli teknik që zbatohen për pajisjet radio.

iii) Teknikave e verifikimit dhe kontrollit të projektit, proceseve dhe veprimet sistematike, që do të përdoren për projektimin e pajisjes radio, që i përkasin tipit të pajisjeve radio të mbuluara;

iv) Prodhimit përkatës, teknikat e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike që do të përdoren;

v) Analizave dhe testeve të cilat do të bëhen para, gjatë dhe pas prodhimit, si dhe frekuenca e realizimit të tyre;

vi) Cilësia e të dhënave, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testeve, kalibrimit, raportet lidhur me kualifikimin e personelit etj.;

vii) Mënyrat e monitorimit të arritjeve të cilësisë së kërkuar të projektit dhe produktit, si dhe operimin efektiv të sistemit të cilësisë.

3.

a) Organi i miratuar do të vlerësojë sistemin e cilësisë, për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3 (2).

b) Ai duhet të presupozojë konformitetin me këto kërkesa referuar elementeve të sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet përkatëse të standardit përkatës të harmonizuar.

c) Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar, që ka përvojë si vlerësues në fushën përkatëse të pajisjeve radio dhe teknologjisë së pajisjeve radio, si dhe njohjen e kërkesave të zbatueshme të këtij rregulli teknik. Auditimi duhet të përfshijë një inspektim vlerësues në ambientet e prodhuesit. Ekipi i auditimit do të rishikojë dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 3(1) (b), për të verifikuar aftësinë e prodhuesit, për të identifikuar kërkesat



e zbatueshme të këtij rregulli teknik dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim sigurimin e pajtueshmërisë së pajisjes radio me kërkesat përkatëse.

ç) Vendimi i njoftohet prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

Njoftimi duhet të përmbajë përfundimet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

d) Prodhuesi duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga miratimi i sistemit të cilësisë dhe ta ruaj atë në mënyrë të përshtatshme dhe efikase.

(dh) Prodhuesi duhet të informojë organin e miratuar që ka miratuar sistemin e cilësisë për çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

Organin i miratuar do të vlerësojë çdo ndryshim të propozuar dhe do të vendosë nëse sistemi i modifikuar i cilësisë do të vazhdojë të përmbushë kërkesat referuar pikës 3(2) apo nevojën e një rivlerësimi. Ai duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të miratuar

1) Qëllimi i mbikëqyrjes është të sigurojë që prodhuesi të përmbushë detyrimet që dalin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

2) Për qëllime të vlerësimit, prodhuesi duhet t'i lejojë organit të miratuar që të ketë qasje në projektimin, prodhimin, inspektimin, testimin dhe magazinimin, si dhe t'i sigurojë të gjitha informacionet e nevojshme, në veçanti:

a) Dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

b) Të dhënat e cilësisë të siguruar nga pala e projektuesit të sistemit të cilësisë të tilla si rezultatet e analizave, llogaritjet, testet etj.;

c) Të dhënat e cilësisë të siguruar nga pala e prodhuesit të sistemit të cilësisë, të tilla si raportet e inspektimit, dhe të dhënat e testeve, kalibrimeve, raportet lidhur me kualifikimin e personelit etj.

3. Organi i miratuar duhet të kryejë auditime periodike, për të siguruar që prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë, si dhe pajis prodhuesin më një raport audit.

4) Përveç kësaj, organi i miratuar mund të bëjë inspektime të papritura tek prodhuesi. Gjatë inspektimeve të tilla, organi i miratuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste të pajisjeve

radio për të kontrolluar funksionimin e duhur të sistemit të cilësisë. Ai duhet ta pajisë prodhuesin me një akt inspektimi dhe, nëse kryhen teste, me një raport testimi.

5. Markimi CE dhe Deklarata e Konformitetit BE

1) Prodhuesi duhet të vendos markimin CE në përputhje me nenin 18 dhe 19 dhe nën përgjegjësinë e organit të miratuar referuar pikës 3(1), numrin e fundit të identifikimit për çdo pjesë të pajisjes radio që plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 3.

2) Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim deklaratën e konformitetit BE për çdo pajisje radio dhe ta ruaj atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për një periudhë 10 vjeçare pasi pajisja radio të jetë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit BE do të identifikojë tipin e pajisjes radio për të cilën ajo është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit do të jetë e disponueshme për autoritetet përkatëse sipas kërkesës.

6. Prodhuesi do të mbajë në dispozicion të autoriteteve kombëtare, për një periudhë 10 vjeçare pasi pajisja radio të jetë vendosur në treg:

a) dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 3(1);

b) dokumentacionin që ka të bëjë me sistemin e cilësisë të përmendur në pikën 3 (1);

c) ndryshimi i referuar në pikën 3(5), të miratuar;

ç) vendimet dhe raportet e organeve të miratuara të përmendura në pikat 3(5), 4(3) dhe 4(4).

7. Çdo organ i miratuar duhet të njoftojë Autoritetin miratues për miratimet ose anulimet e sistemit të cilësisë, dhe në mënyrë periodike ose sipas kërkesës, i vë në dispozicion Autoritetit të tij miratues listën e sistemeve të cilësisë që refuzohen, pezullohen ose kushtëzohen. Secili organ i miratuar duhet të informojë organet e tjerë të miratuara, për miratimet e sistemit të cilësisë të cilat i ka refuzuar, pezulluar ose anuluar dhe, sipas kërkesës, të miratimit të sistemit të cilësisë që ka lëshuar.

8. Përfaqësuesi i Autorizuar

Detyrimet e prodhuesit përcaktuar në pikat 3(1), 3(5), 5 dhe 6 mund të plotësohen dhe nga përfaqësuesi i autorizuar, me kusht që ato të specifikohen në marrëveshje.



ANEKSI V PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT TEKNIK

Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë minimalisht kërkesat e mëposhtme:

a) Përshkrim të përgjithshëm të pajisjes radio duke përfshirë:

-foto ose ilustrime të cilat tregojnë elementet e jashtëm, markimin dhe paraqitjen e brendshme të tij;

-versione të *software* ose *firmware* që ndikojnë në përputhshmërinë me kërkesat thelbësore;

-informacion për përdoruesin dhe udhëzime mbi instalimin;

b) Projektimin konceptual dhe vizatimet e prodhimit, si dhe skemat e komponentëve, qarqeve dhe elementeve të tjerë të ngjashëm;

c) Përshkrimet dhe sqarimet e nevojshme për të kuptuar sa më mirë vizatimet, skemat si dhe funksionimin e pajisjes radio;

ç) Një listë të standardeve të harmonizuara të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare, dhe, në rastin kur standardet e harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për të përmbushur kërkesat thelbësore përcaktuar në nenin 3, duke përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike të aplikuara. Në rast të standardeve të harmonizuara pjesërisht, dokumentacioni teknik specifikon vetëm pjesët që janë zbatuar;

d) Kopje të deklaratës së konformitetit- BE;

dh) Në rastin e zbatimit të modulit të vlerësimit të konformitetit në aneksin III, duhet kopje e Certifikatës së Miratimit Tip- BE dhe anekset e tij lëshuar nga organi i miratuar;

e) Rezultatet e llogaritjeve të projektimit, ekzaminimet e kryera dhe elementë të tjerë të ngjashëm;

ë) Raportet e testeve;

f) Një dokument ku të shpjegojë përputhshmërinë me kërkesën e pikës 2, të nenit 9 dhe përfshirjen ose jo të informacionit mbi paketimin në përputhje me pikën 10, të nenit 9.

ANEKSI VI DEKLARATA E KONFORMITETIT (NR XXX) NË VENDET E BE/ SHQIPËRI

1. Pajisja radio (produkti, tipi, grupi ose numri i serisë):_____.

2. Emri dhe adresa e prodhuesit ose e përfaqësuesit të tij të autorizuar:_____.

3. Kjo deklaratë konformiteti lëshohet nën përgjegjësinë e prodhuesit.

4. Objekti i deklaratës (identifikimi i pajisjes radio që lejon gjurmimin; ai mund të përfshijë një imazh me ngjyra me qartësi të mjaftueshme për identifikimin e pajisjes radio).

5. Objekti i deklaratës përshkruar më sipër është në përputhje me legjislacionin e harmonizuar të vendeve të Bashkimit:

- Këtij rregulli teknik;

- Legjislacion tjetër i harmonizuar i vendeve të Bashkimit kur është e aplikueshme.

6. Referencat për përdorimin e harmonizuar të standardeve përkatëse ose referencat për specifikimet e tjera teknike në lidhje me të cilat është deklaruar konformiteti. Referencat duhet të renditen me numrin e tyre të identifikimit dhe versionin si dhe në rastet kur është e mundur, datën e lëshimit.

7. Në rastet kur është e aplikueshme, organi i miratuar...(emër, numër)...ka kryer(përshkrimi i aktiviteteve)..... dhe lëshoi Certifikatën e Miratimit të Tipit- BE:.....

8. Në rastet kur është e aplikueshme, përshkrimi i aksesorëve ose komponentëve, duke përfshirë dhe *software*-et të cilat bëjnë të mundur operimin siç duhet të pajisjes radio mbuluar dhe nga deklarata e konformitetit BE.

9. Informacion plotësues:

Nënshkruar për dhe në emër të:.....

(vendi dhe data e lëshimit):

(emri, funksioni) (firma):.....

ANEKSI VII DEKLARATA E KONFORMITETIT E THJESHUAR

Deklarata e Konformitetit e Thjeshtuar, referuar pikës 9, të nenit 10, do të sigurohet si më poshtë:

Me anë të kësaj deklaratë, subjekti [emri i prodhuesit] deklaron se pajisjet radio [tipi i



pajisjes radio] është në përputhje me këtë rregull teknik për pajisjet radio dhe fundore të komunikimeve elektronike.

Teksti i plotë i Deklaratës së Konformitetit është i disponueshëm në adresën e mëposhtme të internetit: www.akep.al.

ANEKSI VIII LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar (dhe dokumenti i referencës)	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar në shqip	Viti i adoptimit si SSH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë FP ose me përkthim të plotë PP)
1.	EN 50360:2017 Product standard to demonstrate the compliance of wireless communication devices, with the basic restrictions and exposure limit values related to human exposure to electromagnetic fields in the frequency range from 300 MHz to 6 GHz: devices used next to the ear	SSH EN 50360:2017 Standard produkti për të demonstruar përputhjen e pajisjeve të komunikimit pa tel me kufizimet bazë dhe vlerat limit të ekspozimit në lidhje me ekspozimin e njeriut ndaj fushave elektromagnetike në diapazonin e frekuencave nga 300 MHz deri në 6 GHz: pajisjet e përdorura ngjitur me veshin	2018	FP
2.	EN 50385:2017 Product standard to demonstrate the compliance of base station equipment with radiofrequency electromagnetic field exposure limits (110 MHz - 100 GHz), when placed on the market	SSH EN 50385:2017 Standard produkti për të vërtetuar përputhshmërinë e pajisjeve të stacionit bazë me limitet e ekspozimit ndaj fushës elektromagnetike të frekuencave të radios (110 MHz - 100 GHz), kur vendosen në treg	2018	FP
3.	EN 50401:2017 Product standard to demonstrate the compliance of base station equipment with radiofrequency electromagnetic field exposure limits (110 MHz - 100 GHz), when put into service	SSH EN 50401:2017 Standard produkti për të vërtetuar përputhshmërinë e pajisjeve të stacionit bazë me limitet e ekspozimit ndaj fushës elektromagnetike të frekuencave të radios (110 MHz - 100 GHz), kur vendosen në shërbim	2018	FP
4.	EN 50566:2017 Product standard to demonstrate the compliance of wireless communication devices with the basic restrictions and exposure limit values related to human exposure to electromagnetic fields in the frequency range from 30 MHz to 6 GHz: hand-held and body mounted devices in close proximity to the human body	SSH EN 50566:2017 Standard produkti për të demonstruar përputhshmërinë e pajisjeve të komunikimit pa tel me kufizimet bazë dhe vlerat limit të ekspozimit lidhur me ekspozimin e njeriut ndaj fushave elektromagnetike në gamën e frekuencave nga 30 MHz deri 6 GHz: pajisjet që mbahen në dorë dhe të montuara në trup shumë afër trupit të njeriut	2018	FP
5.	EN 55035:2017 Electromagnetic compatibility of multimedia equipment - Immunity requirements CISPR 35:2016 (Modified)	SSH EN 55035:2017 Përputhshmëria elektromagnetike për pajisjet multimediale - Kërkesat për imunitetin	2018	FP
6.	EN 300 065 V2.1.2:2016 Narrow-band direct-printing telegraph equipment for receiving meteorological or navigational information (NAVTEX); Harmonised Standard covering the essential requirements of articles 3.2 and 3.3(g) of the Directive 2014/53/EU	SSH EN 300 065 V2.1.2:2016 Pajisjet e telegrafit me bandë të ngushtë dhe printim të drejtpërdrejtë për marrjen e informacioneve meteorologjike ose të lundrimit (NAVTEX); Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 dhe 3.3(g) të Direktivës 2014/53/E	2017	FP



7.	EN 300 086 V2.1.2:2016 Land Mobile Service; Radio equipment with an internal or external RF connector intended primarily for analogue speech; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU	SSH EN 300 086 V2.1.2:2016 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje radio me një lidhës RF të brendshëm ose të jashtëm të destinuar kryesisht për komunikim analog; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU	2017	FP
8.	EN 300 113 V2.2.1:2016 Land Mobile Service; Radio equipment intended for the transmission of data (and/or speech) using constant or non-constant envelope modulation and having an antenna connector; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU	SSH EN 300 113 V2.2.1:2016 Shërbimi tokësor i lëvizshëm; Pajisje radio të destinuara për transmetimin e të dhënave (dhe/ose të të folurit) që përdorin një modulim me mbulim konstant ose jo-konstant dhe që kanë një bashkues për antenë; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU	2017	FP
9.	EN 300 219 V2.1.1:2016 Land Mobile Service; Radio equipment transmitting signals to initiate a specific response in the receiver; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU	SSH EN 300 219 V2.1.1:2016 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje radio që transmetojnë sinjale për të iniciuar një përgjigje specifike tek marrësi; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU	2017	FP
10.	EN 300 220-2 V3.1.1:2017 Short Range Devices (SRD) operating in the frequency range 25 MHz to 1 000 MHz; Part 2: Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU for non specific radio equipment	SSH EN 300 220-2 V3.1.1:2017 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD) që punojnë në diapazonin e frekuencave nga 25 MHz deri në 1 000 MHz; Pjesa 2: Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU për pajisjet radio jo-spezifike	2017	FP
11.	EN 300 220-3-1 V2.1.1:2016 Short Range Devices (SRD) operating in the frequency range 25 MHz to 1 000 MHz; Part 3-1: Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU; Low duty cycle high reliability equipment, social alarms equipment operating on designated frequencies (869,200 MHz to 869,250 MHz)	SSH EN 300 220-3-1 V2.1.1:2016 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD) që punojnë në diapazonin e frekuencave nga 25 MHz deri në 1 000 MHz; Pjesa 3-1: Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU; Cikël i ulët pune për pajisje të besueshmërisë së lartë, alarme sociale dhe pajisjet që punojnë në frekuenca të caktuara (869.200 MHz për 869.250 MHz)	2017	FP
12.	EN 300 220-3-2 V1.1.1:2017 Short Range Devices (SRD) operating in the frequency range 25 MHz to 1 000 MHz; Part 3-2: Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU; Wireless alarms operating in designated LDC/HR frequency bands 868,60 MHz to 868,70 MHz, 869,25 MHz to 869,40 MHz, 869,65 MHz to 869,70 MHz	SSH EN 300 220-3-2 V1.1.1:2017 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD) që punojnë në diapazonin e frekuencave nga 25 MHz deri në 1 000 MHz; Pjesa 3-2: Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU; Alarmet pa kabëll (Wireless) që punojnë në bandat e frekuencave të përcaktuara LDC/HR 868,60 MHz në 868,70 MHz, 869,25 MHz në 869,40 MHz, 869,65 MHz në 869,70 MHz	2017	FP
13.	EN 300 220-4 V1.1.1:2017 Short Range Devices (SRD) operating in the frequency range 25 MHz to 1 000 MHz; Part 4: Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU; Metering devices	SSH EN 300 220-4 V1.1.1:2017 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD) që punojnë në diapazonin e frekuencave nga 25 MHz deri në 1 000 MHz; Pjesa 4: Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU;	2017	FP



	operating in designated band 169,400 MHz to 169,475 MHz	Pajisjet e matjes që punojnë në bandë të përcaktuara 169,400 MHz në 169,475 MHz		
14.	EN 300 224 V2.1.1:2017 Land Mobile Service; Radio Equipment for use in a Paging Service operating within the frequency range 25 MHz - 470 MHz; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU	SSH EN 300 224 V2.1.1:2017 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje Radio për përdorim në një Shërbim Faqosje që punojnë brenda diapazonit të frekuencave 25 MHz - 470 MHz; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU	2018	FP
15.	EN 300 224-2 V1.1.1:2001 Electromagnetic compatibility and Radio spectrum Matters (ERM); On-site paging service; Part 2: Harmonized EN under article 3.2 of the R&TTE Directive	SSH EN 300 224-2 V1.1.1:2001 Çështjet e pajtueshmërisë Elektromagnetike dhe të spektrit të Radios (ERM); Shërbimi i faqosjes në vënd; Pjesa 2: EN i harmonizuar sipas artikullit 3.2 të direktivës R&TTE	2013	FP
Ky standard i harmonizuar nuk i adresohet kërkesave lidhur me parametrat e performancës së marrësit dhe nuk jep prezumimin e konformitetit për këto parametra.				
16.	EN 300 296 V2.1.1:2016 Land Mobile Service; Radio equipment using integral antennas intended primarily for analogue speech; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU	SSH EN 300 296 V2.1.1:2016 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje radio që përdorin antena integrale të destinuara kryesisht për komunikim analog; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53EU	2016	FP
17.	EN 300 328 V2.1.1:2016 Wideband transmission systems; Data transmission equipment operating in the 2,4 GHz ISM band and using wide band modulation techniques; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU	SSH EN 300 328 V2.1.1:2016 Sistemet e transmetimit me brez të gjerë; Pajisje të transmetimit të të dhënave që punojnë në bandën 2,4 GHz ISM dhe që përdor teknika modulimi me bandë të gjerë; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU	2017	FP
18.	EN 300 330 V2.1.1:2017 Short Range Devices (SRD); Radio equipment in the frequency range 9 kHz to 25 MHz and inductive loop systems in the frequency range 9 kHz to 30 MHz; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU	SSH EN 300 330 V2.1.1:2017 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD); Pajisje radio në diapazonin e frekuencave 9 kHz deri në 25 MHz dhe sistemet e cikleve induktive në diapazonin e frekuencave 9 kHz deri në 30 MHz; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU	2017	FP
